



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:129399

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528962

KPPP.nr.20/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO) me seli në Prishtinë, rr. “UÇK”-së, nr.51, kundër debitorit 1. “N.P.T.SH “FLORIMI”, me adresë në Viti, rruga e Preshevës, me NRB: 80191219, 2. A.R., nga Vitia si përfaqësues dhe kredimarrës, 3. M.R. (garantues) nga fshati Gjylekar, Komuna e Vitisë, dhe 4. N.T.P “City Style-F” (garantues) me adresë rruga e Ferizajit në Gjilan, me NRB: 70804085, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit “N.P.T.SH “FLORIMI”, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.637/15 të datës 11.11.2015 të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 20.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit A.R., nga Vitia si përfaqësues dhe kredimarrës “N.P.T.SH “FLORIMI”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.637/15 të datës 11.11.2015, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin ndaj debitorëve 1. N.P.T.SH “FLORIMI” me seli në Viti, me NRB: 80191219, 2. A.R., nga Vitia si përfaqësues dhe kredimarrës, 3. M.R. (garantues) nga fshati Gjylekar, Komuna e Vitisë, dhe 4. N.T.P “City Style-F” (garantues) me adresë rruga e

Ferizajit në Gjilan, në bazë të Marrëveshjes Kryesore nr.229, Marrëveshjes mbi Linjën e Kredisë nr.40004604 në kuadër të Marrëveshjes Kryesore nr.229, Shtojcës nr.2 të Marrëveshjes mbi Linjën e Kredisë nr.40004604, dhe Marrëveshjes mbi Hipotekën nr.229/H të datës 28.06.2010, duke i detyruar debitorët që në afat prej 7 ditësh, të paguajnë shumën prej 16,056.73 Euro si dhe kamata e rregullt dhe kamatëvonesa që do të arrij deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore. Të bllokohen të gjitha llogaritë nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të gjithë debitorëve duke bërë pagesën me bartje të mjeteve nga llogaria e debitorëve në llogarinë e kreditorit, nëse Përmbartuesi Privat apo kreditori mëson për ekzistimin e këtyre mjeteve në ndonjë llogari.

Kundër urdhrin përbarimor në afatin e paraparë ligjor ka ushtruar prapësim debitori "N.P.T.SH "FLORIMI", me përfaqësues A.R., me arsyetimin se ka kërkuar nga kreditori që ta bëjnë një marrëveshje të re për shumën e kredisë në shumën prej 16,056.73 Euro, duke shtuar se kohëve të fundit ka kërkuar nga kreditori që t'i mundësoj një afat kohor pa kamata ndëshkuese deri në muajin qershor të vitit 2016, në mënyrë që të ketë kohë për rikuperim të biznesit dhe t'i paguaj këstet e kredisë së mbetur.

Kreditori në përgjigje në prapësim e ka cilësuar prapësimin e debitorit si të pathemeltë dhe të pabazuar, me arsyetimin se debitori asnjë nga shkaqet e prapësimit të parapara sipas dispozitës 71 të LPP-së, nuk i ka mbështetur me asnjë provë. Më tej ka shtuar se kreditori nuk merr përgjegjësi në rast të paraqitjes së vështirësive ekonomike të debitorit, prandaj kredia është siguruar me koltateral të lënë peng nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të veproj me urgjencë konform dispozitave ligjore në fuqi, për të mos lejuar që lënda të zvarritet pa arsye, duke kërkuar që të hudhet prapësimi i debitorit si i pabazuar.

Gjykata Themelore në Gjilan – dega në Viti, me aktvendimin PPP.nr.54/2015 të datës 30.12.2015, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit A.R., si përfaqësues i N.P.T.SH "FLORIMI" me seli në Viti, dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përbarimor P.nr.637/15 të datës 11.11.2015 të Përmbartuesit Privat.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin AC.nr.2931/2020 të datës 22.04.2021 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit, duke e anuluar vendimin e shkallës së parë PPP.nr.54/2015 të datës 30.12.2015, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë është dashur që të caktojë seancë dëgjimore në mënyrë që t'iu jepet mundësia e deklarimit të parashtrimeve të tyre lidhur me rregullsinë e propozimit për

përmbarrim dhe përmbushjen e detyrimit, dhe e ka udhëzuar që në ri procedurë t'i evitohet të metat dhe të marr parasysht faktet tjera relevante për vendosje.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbarruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se dokument përmbarrues paraqet *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e Përmbarruesit Privat bazohet në dokumentin përmbarrues përkatësisht Marrëveshjen mbi Hipotekën nr.229/H të datës 28.06.2010, e cila i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenit 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, për t'u paraqitur si dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase Marrëveshja mbi Hipotekën nr.229/H e datës 28.06.2010, është e regjistruar në regjistrin e hipotekës sipas Aktvendimit mbi Regjistrimin e Hipotekës me nr.të protokollit nr.951-1186-2010, të datës 05.07.2010.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarrimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarrimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet

urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.20/2022, me datë 20.03.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate